



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202201190/4

Tiranë ___/___/2023

Lënda: Rekomandim për krijimin e mjediseve të përshtatshme për nxënie efektive, nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës në shkollën 9-vjeçare "Jonuz Çarçiu" në fshatin Tregan, në Bashkinë Elbasan

MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT

BASHKISË ELBASAN

ELBASAN

Të nderuar,

Institucioni i Avokatit të Popullit (AP), nga publikimi në mediat *online* është vënë në dijeni të lajmit lidhur me mbylljen e shkollës 9-vjeçare "Jonuz Çarçiu" në fshatin Tregan, në Bashkinë Elbasan, e cilësuar jo-funksionale nga Komisioni i Verifikimit, pas tërmetit të 26 nëntorit 2019. Pavarësisht se kanë kaluar rreth 3 vite, punimet në këtë institucion të edukimit ende nuk kanë filluar. Kjo ka çënuar të drejtën e 170 fëmijëve për t'u arsimuar, të cilët e kanë filluar vitin e ri shkollor 2022-2023, në mjediset e institucionit të edukimit të fshatit Kuqan, 5 km larg vendbanimit të tyre.

Bazuar në nenin 13, të ligjit nr. 8454 datë 4.2.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, (ligji nr.8454/1999) AP-ja filloi procedurën e shqyrtimit të çështjes me nismën e vet, për rastin e bërë publik, duke kërkuar informacion zyrtar nga Bashkia Elbasan¹. Bashkia Elbasan në komunikimin zyrtar informon se shkolla 9-vjeçare "Jonuz Carciu" në fshatin Tregan të Njësisë Administrative Tregan është cilësuar jo-funksionale nga Komisioni i Verifikimit pas tërmetit të 26 nëntorit 2019. Bashkia Elbasan ka përfunduar

¹ Shkrese zyrtare me nr.K5/I53-2prot., datë 19.10.2022 të Avokatit të Popullit

projektin dhe është në pritje të financimit për ndërtimin e saj nga programi i rindërtimit².

Në këto kushte, AP-ja kërkoi informacion zyrtar nga Ministria e Rindërtimit për masat e marra për të bërë të mundur financimin e projektit të realizuar nga Bashkia Elbasan për ndërtimin e shkollës 9-vjeçare “Jonuz Carciu”³. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka pohuar se “bazuar vendimin nr.885, datë 24.12.2019 të Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në vendimin nr. 750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Lezhë dhe Tiranë” të ndryshuar, Bashkia Elbasan nuk bën pjesë në skemën e programit të rindërtimit dhe rasti në fjalë nuk mund të trajtohet nga institucioni ynë. Bashkia Elbasan, e cila disponon projektin e zbatimit duhet t’i drejtohet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për financimin e ndërtimit të objektit, të shkollës 9-vjeçare “Jonuz Carciu” në fshatin Tregan të Njësisë Administrative Tregan, Bashkia Elbasan”⁴.

Në vijim të hetimit administrativ, me qëllim sqarimin e fakteve e të rrethanave të sipërcituara, AP-ja i është drejtuar zyrtarisht Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS) dhe përsëri Bashkisë Elbasan⁵.

Në vlerësim të përgjigjes zyrtare të MAS-it, jemi informuar si vijon:

- nga komunikimi zyrtar ndërmjet MAS-it dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, rezulton se godina e shkollës 9-vjeçare “Jonuz Çarçiu”, Tregan në Bashkinë Elbasan, pas rënies së tërmetit të datës 26.11.2019 dhe inspektimit të datës 27.11.2019 është shpallur e pabanueshme nga Komisioni i Evidentimit të dëmeve të Bashkisë Elbasan, sipas relacionit me nr.864 prot., datë 30.11.2019. Në këto kushte u morën masa për zhvillimin e procesit mësimor pranë shkollës 9-vjeçare, Kuqan dhe gjimnazit “Anastas Çakalli”, Kuqan, duke siguruar transportin e nxënësve në linjën Tregan-Kuqan-Tregan. Zyrtarisht janë njoftuar shkollat pritëse mbi mënyrën se si do të zhvillohet procesi mësimor me dy turne⁶. Ndërkohë, drejtorja e shkollës 9-vjeçare “Jonuz Çarçiu” hartoi grafikun e mësuesve të cilët do të bënin shoqërimin e nxënësve nga fshati Tregan në Kuqan dhe anasjelltas, si dhe informuan prindërit për zhvillimin e procesit

² Shkresë zyrtare me nr.4964/1prot., datë 31.10.2022 të Bashkisë Elbasan

³ Shkresa zyrtare me nr.827/1prot., datë 6.2.2023 të ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë

⁴ Shkresa zyrtare me nr.K5/I 53-4 prot., datë 17.1.2023 të institucionit të Avokatit të Popullit

⁵ Shkresa zyrtare me nr.K5/I53-7prot., datë 17.2.2023 të institucionit të Avokatit të Popullit

⁶ Shkresa zyrtare me nr.864/1port., datë 30.11.2019 e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit

mësimor në shkollat e fshatit Kuqan, si dhe mënyrën e lëvizjes së nxënësve;

- në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore si dhe bazuar në shkresën zyrtare të MAS-it, ndërtimi, rindërtimi, mirëmbajtja dhe funksionimi i shkollave dhe godinave arsimore është funksion i plotë i Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, në këtë rast, Bashkisë Elbasan. Konkretisht në zbatim të nenit 23, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ligjit nr.68, datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të ligjit 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të pikës 4, të urdhërit të Kryeministrit nr.127, datë 16.9.2015 “Për marrjen e masave në kuadër dhe në funksion të zbatimit të strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore”, si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore të nxjerra në zbatim të tyre, ndërtimi rindërtimi, mirëmbajtja dhe funksionimi i shkollave dhe godinave është funksion dhe kompetencë e plotë e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore. Gjithashtu, në udhëzimin nr.9, datë 20.3.2018 të ministrit të Financave dhe të Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, përcaktohet se: *“Bashkitë kanë kompetencë të plotë për të siguruar mirëmbajtjen dhe funksionimin e të gjitha ambienteve të arsimit parauniversitar në komunitetin e tyre. Fondet për mirëmbajtjen dhe funksionimin e ambienteve të arsimit parauniversitar janë të përfshira në burimet e veta vendore. Çdo bashki vendos nivelin e financimit që ajo akordon për funksion nga të gjitha buxhetet e tyre”* si dhe *..”Ministria përgjegjëse për arsimin përgatit dhe nxjerr standarde kombëtare të sigurisë dhe të shëndetit, të zbatueshme për ambientet e arsimit parauniversitar. Këto standarde nuk duhet të kufizojnë vendimmarrjen e bashkive në fushat me interes të qartë vendor. Shpenzimet e lidhura me funksionimin dhe mirëmbajtjen e ambienteve të arsimit parauniversitar miratohen si pjesë e buxhetit të çdo njësie të vetëqeverisjes vendore”,* pra Bashkia Elbasan duhet të vendos fondet e rindërtimit të kësaj shkolle⁷.

Bashkia Elbasan na ka informuar se megjithëse ka përfunduar projektin e shkollës 9-vjeçare “Jonuz Çarçiu” është në pamundësi për të përfshirë në buxhetin e saj të gjithë ndërtimin e këtij institucioni arsimor dhe ka aplikuar disa herë për financimin e projektit për ndërtimin e këtij institucioni arsimor në thirrjet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit⁸.

⁷ Shkresa përcjellëse me nr.1789/1prot., datë 3.3.2023 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit

⁸ Shkresa përcjellëse me nr.1799/1prot., datë 17.3.2023 të Bashkisë Elbasan

Në vlerësim të përgjigjeve zyrtare të organeve të administratës publike (Bashkisë Elbasan dhe MAS) dhe bazës ligjore për financimin dhe realizimin e shërbimit arsimor publik⁹, AP-ja konstaton si vijon:

Fondet e parashikuara për periudhën 2022-2024, sipas strukturës të grup-artikujve buxhetorë të shpenzimeve për Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë në zërin infrastruktura –investimet, planifikimi i fondeve për grupin e shpenzimeve kapitale për këtë periudhë (2022-2024) në arsimin parauniversitar janë parashikuar ***17 miliard e 149 milion lekë***, të detajuar për çdo vit të PBA me një rritje mesatare që shkon nga 48.2% në 11.2%. Fondet për investime kapitale në vitin 2022, janë 4 miliard e 231 milion lekë ose 48% e fondeve të miratuar për MAS 2021. Në vitin 2022, ka një rritje prej 1.28 miliard lekë ose 48.3%

- *në vitin 2023* fondet për investime arrijnë në 4 miliard 734 milion lekë ose 12.8% e fondeve të miratuar për MAS me një rritje prej 503 milion lekë ndaj vitit 2022,
- *në vitin 2024* fondet për investime arrijnë në 5 miliard 234 milion lekë ose 10% e fondeve të miratuar për MAS, me një rritje prej 500 milion lekë ndaj vitit 2023 ose 11.3% më shumë se në vitin 2023¹⁰.

MAS-i ka miratuar dy akte nënligjore për kriteret, procedurat dhe afatet për shpalljen e thirrjes dhe për dokumentacionet e nevojshme për aplikim nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për financimin/bashkëfinancimin e projekteve për përmirëimin e infrastukturës shkollore, konkretisht:

- *për vitin 2022* vlera e financimit nga MAS për programin buxhetor 09120 “Arsimi Bazë” ka qënë në shumën prej 360 000 000 lek (treqind e gjashtëdhjetë milion lekë);¹¹
- *për vitin 2023* vlera e financimit nga MAS për programin buxhetor 09120 “Arsimi Bazë” ka qënë në shumën prej 724 380 000 lek (shtatë qind e njëzetë e katër mijë e e treqind e tetëdhjetë milion lekë)¹².

⁹neni 57 i Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, ligji nr. 69/2012, datë 21.06.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligji nr.10296, datë 08/07/2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”; ligji nr.137/2020, datë 16.12.2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, vendimi nr. 90, datë 17.2.2021 Këshillit të Ministrave “Për miratimin e programit të reformave ekonomike (erp) 2021–2023”;vendimi nr. 185, datë 29.3.2018 i Këshillit të Ministrave “Për Procedurat e Menaxhimit të Investimeve Publike”, udhëzimi nr.7 datë 27.2.2018 i Ministrit të Financës dhe Ekonomisë “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021”, udhëzimi Plotësues nr.8 datë 26.02.2021 i Ministrit të Financës dhe Ekonomisë “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”.

¹⁰Relacion mbi hartimin programit afatmesëm buxhetor për periudhën 2022-2024, për Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë, (fq 20)

¹¹Urdhëri nr.245, datë 9.5.2022 të ministrit të Arimit dhe Sportit “Për shpalljen e thirrjes për financimin e projekteve për infrastrukturën shkollore e sportive, për njësitë e vetëqeverisjes vendore për projektet me cikël financimi 2022-2023”

¹²Urdhëri nr.146, datë 24.3.2023 të ministrit të Arimit dhe Sportit “Për shpalljen e thirrjes për financimin e projekteve për infrastrukturën shkollore e sportive, për njësitë e vetëqeverisjes vendore për projektet me cikël financimi 2023-2024”

Konkluzionet: MAS-ja disponon fonde për investime në arsimin parauniversitar, ku përfshihet arsimi bazë për periudhën 2022-2024, pasi ka miratuar fonde për investime në arsimin parauniversitar për vitin 2022 dhe 2023. Në të cilën Bashkia Elbasan, për rastin në fjalë (shkolla 9-vjeçare “Jonuz Çarçiu”) nuk ka qënë përfituese, pavarësisht se ka aplikuar disa herë për financimin e projektit në thirrjet e MAS-it.

AP-ja bazuar në informacionin zyrtar të MAS-it se “...në zbatim të aktve ligjore dhe nënligjore, ndërtimi, rindërtimi, mirëmbajtja dhe funksionimi i shkollave dhe godinave është funksion dhe kompetencë e plotë e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, në këtë rast, e Bashkisë Elbasan, e cila duhet të vendosë fondet për rindërtimin e kësaj shkolle..”, informohet se Bashkia Elbasan nuk ka planifikuar/miratuar fonde nga buxheti i saj për rindërtimin e këtij institucioni arsimor. Kjo, pasi për t’u bërë pjesë e përfitimeve të këtyre fondeve domosdoshmërisht është e nevojshme, që njësitë e vetëqeverisjes vendore të plotësojnë dokumentacionet e duhura në përputhje me kriteret dhe procedurat e miratuara me udhëzimin nr.9, datë 27.4.2022 të ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për kriteret, procedurat dhe afatet për shpalljen e thirrjes për dokumentacionin e nevojshëm nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për financimin e projekteve për përmirësimin e infrastrukturës shkollore dhe sportive” (udhëzimi nr.9/2022). Në rastin konkret, Bashkia Elbasan duhet të përcaktojë dhe vlerën e financimit/bashkëfinancimit për projektin që aplikon¹³.

Bazuar në pikën 8, të udhëzimit nr.9/2022 të ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për kriteret, procedurat dhe afatet për shpalljen e thirrjes për dokumentacionin e nevojshëm nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për financimin e projekteve për përmirësimin e infrastrukturës shkollore dhe sportive” (udhëzimi nr.9/2022) përcaktohet se “..në të gjitha rastet, kur në shpalljen e thirrjes për aplikim parashikohet bashkëfinancimi i projektit, NJVV-ja duhet të paraqesë në aplikim edhe konfirmimin zyrtar të miratuar nga organi kolegjal i NJVV-së, i përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi, për marrjen përsipër të pjesës taksuese të bashkëfinancimit. Aplikimi nuk i nënshtrohet procesit të shqyrtimit, në rast të mungesës së këtij dokumenti”.

Pra, Bashkia Elbasan me Vendim të Këshillit Bashkiak duhet të miratonte përqindjen e fondeve për bashkëfinancim për rikostruksionin e shkollës 9-vjeçare “Jonuz Çarçiu” nga fondet e bashkisë bazuar në udhëzimin nr.9/2022.

¹³Gërma “d”, e pikës 2, të udhëzimit nr.9, datë 27.4.2022 të ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për kriteret, procedurat dhe afatet për shpalljen e thirrjes për dokumentacionin e nevojshëm nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për financimin e projekteve për përmirësimin e infrastrukturës shkollore dhe sportive”

AP-ja monitoroi *on-line* të gjitha vendimet e këshillit bashkiak të Bashkisë Elbasan të publikuara në faqen zyrtare të këtij institucioni, në të cilën nuk rezulton asnjë vendim i këshillit bashkiak i publikuar lidhur me miratimin e fondeve për financim/bashkëfinancim për projektin e rikonstruksionit të shkollës 9-vjeçare “Jonuz Çarçiu”¹⁴.

Financimi për shkollat përcaktohet në nivel qendror dhe menaxhohet në nivelin rajonal dhe vendor. Fondet vijnë nga buxheti qendror pranë DRAP-eve dhe ZVAP-ve, por fondet e tjera qendrore administrohen nga NJQV-të. Buxhetet e DRAP-eve dhe ZVAP-ve mbulojnë kostot e shumicës së shërbimeve në arsim (p.sh., pagat e mësuesve) si dhe ato për ndërtimin, infrastrukturën, mirëmbajtjen dhe shërbimet¹⁵. Pra, organet përgjegjëse vendimarrëse në lidhje me burimet financiare për shkollat janë ministria, drejtoritë rajonale, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Bashkitë kanë kompetencë të plotë për të siguruar mirëmbajtjen dhe funksionimin e të gjitha ambienteve të arsimit parauniversitar në komunitetin e tyre. Fondet për mirëmbajtjen dhe funksionimin e ambienteve të arsimit parauniversitar janë të përfshira në burimet e veta vendore. Çdo bashki vendos nivelin e financimit që ajo akordon për këtë funksion, nga të gjitha burimet e disponueshme në buxhetin e saj. Ministria përgjegjëse për arsimin dhe shkencën përgatit dhe nxjerr standarde kombëtare të sigurisë dhe të shëndetit, të zbatueshme për ambientet e arsimit parauniversitar. Këto standarde nuk duhet të kufizojnë vendimmarrjen e bashkive në fushat me interes të qartë vendor. Shpenzimet e lidhura me funksionimin dhe mirëmbajtjen e mjediseve të arsimit parauniversitar miratohen si pjesë e buxhetit të çdo njësie të vetëqeverisjes vendore. **Njësitë e qeverisjes vendore mund të përfitojnë fonde nga ministria përgjegjëse për arsimin për investime në arsimin parauniversitar.** Gjithashtu, njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të financojnë edhe nga të ardhurat e veta investime në arsimin parauniversitar. Njësitë e vetëqeverisjes vendore respektojnë standardet kombëtare të vendosura nga ministria përgjegjëse për arsimin, e cila nëpërmjet strukturave të saj, monitoron, vlerëson dhe kontrollon zbatimin e standardeve¹⁶ të vendosura nga ajo për rikonstruksion, ndërtim dhe pajisje të ambienteve të arsimit parauniversitar¹⁷.

¹⁴ <https://elbasani.gov.al/keshilli/vendimet-e-keshillit/>

¹⁵ Ligji nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

¹⁶ Standartet e miratuara nga MAS me Udhëzuesin “Për projektimin e ndërtimeve shkollë, normat dhe standardet”, “https://arsimi.gov.al/ep-content/uploads/2018/08/Norma_Dhe_Standarte_projektimi.pdf”

¹⁷ Pika 121 dhe 123 e Udhëzimit nr.9, datë 20.3.2018, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

AP-ja shpreh shqetësimin se një ndër elementët e largimit të të rinjve nga vendi ynë lidhet dhe me moskrijimin e mjediseve të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor cilësor, sidomos në zonat rurale të vendit.

Në këtë mënyrë mund të realizohet një plan i qendëruar i ndërhyrjeve të nevojshme. AP-ja vlerëson se Ministria e Arsimit dhe Sportit duhet të kryejë një vlerësim të përgjithshëm të gjendjes infrastrukturore të institucioneve arsimore në vend dhe të evidentojë qartë nevojat në bashkëpunim edhe me pushtetin vendor.

Institucionet kanë detyrimin të sigurojnë që fëmijët dhe të rinjtë të trajtohen si duhet në shkollë dhe, të drejtat e tyre të mos shkelen, kjo me qëllim ofrimin e kushteve të përshtatshme jo vetëm për realizimin e procesit mësimor por edhe të veprimtarive me karakter sportiv, edukativ, kulturor e dëfryes, në përshtatje me moshën e tyre¹⁸.

Ekzistenca e një godine funksionale dhe mirëfunksionimi i mjediseve të brendshme të saj, me mjetet dhe pajisjet e nevojshme, është e rëndësishme për zhvillimin korrekt dhe sipas standardeve të procesit të edukimit/arsimit dhe aftësimin fizik të fëmijëve/nxënës¹⁹. Arsimitimi i fëmijës duhet të zhvillojë potencialin e plotë të personalitetit, dhuntive dhe aftësive mendore e fizike të tij²⁰. Prandaj, është e nevojshme të merren të gjitha masat, për krijimin e mundësive infrastrukturore të përshtatshme, ku përpos edukimit, t'i nxisim fëmijët edhe drejt një qasjeje të realizimit të plotë të të gjithë orarit mësimor.

Nenet 3, 21 dhe 22, të ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, parashikojnë se: “... *arsimi parashkollor dhe ai bazë synojnë zhvillimin shoqëror, intelektual e fizik, të çdo fëmije, ushtrimin e rregullave themelore të sjelljes e të higjienës, kultivimin e vlerave, si dhe përgatitjen për arsimin fillor, zhvillimin shoqëror, intelektual e fizik, të çdo nxënësi, zotërimin e rregullave të sjelljes dhe kultivimin e vlerave, përkujdesjen për shëndetin, si dhe përgatitjen e mjaftueshme për vazhdimin e arsimit të mesëm të lartë ose për tregun e punës...*”.

AP-ja konstaton se në rastin konkret nuk ka patur një bashkëpunim të punë për arritjen e qëllimit të përbashkët, cka edhe ka rezultuar nga përgjigjet kondradiktore të institucioneve.

¹⁸ Shkronja “c”, e pikës 2, të nenit 19, të ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

¹⁹“Program mësimor” është dokumenti që përmban synimet, objektivat dhe rezultatet e të nxënës, metodologjitë e të nxënës dhe të vlerësimit për një lëndë ose fushë të caktuar.

²⁰ Shkronja “a”, e nenit 29, e Konventës të OKB-së mbi të Drejtat e Fëmijës.

Ndërkaq, institucionet shtetërore përgjegjëse duhet të marrin masa konkrete që të inkurajojnë, motivojnë dhe të rrisin cilësinë e arsimit të fëmijëve/nxënës, nëpërmjet krijimit të kushteve të nevojshme infrastrukturore, si dhe ofrimit të mjeteve të domosdoshme mësimore²¹, me qëllim edukimin dhe aftësimin e fëmijëve. Kjo e drejtë themelore dhe e patjetërsueshme shkon paralelisht edhe me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (konkretisht objektivi 4.1), i cili pohon rëndësinë e sigurimit të një arsimit gjithëpërfshirës, me cilësi të barabartë dhe promovimin e mundësive të të mësuarit përgjatë gjithë jetës. Autoritetet shtetërore deri në vitin 2030, duhet të sigurojnë që të gjithë fëmijët/nxënësit të kryejnë arsimin fillor dhe të mesëm falas, të drejtë dhe cilësor, duke çuar në rezultate të rëndësishme dhe efektive të të nxënit.

Për sa më sipër, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës në interesin më të lartë të tyre dhe, në zbatim të legjislacionit të mbrojtjes së fëmijës, me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në fushën e arsimit dhe, në mbështetje të nenit 21, të ligjit nr.8454/1999 AP-ja:

REKOMANDON:

- Marrjen e masave nga Bashkia e Elbasanit për miratimin e fondit nga buxheti i saj në përputhje me kriteret e përcaktuara në udhëzimin nr.9, datë 27.4.2022 të ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për kriteret, procedurat dhe afatet për shpalljen e thirrjes për dokumentacionin e nevojshëm nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për financimin e projekteve për përmirësimin e infrastrukturës shkollore dhe sportive”, për të mundësuar edhe mbështetjen financiare nga MAS-i për rindërtimin e shkollës 9-vjeçare “Jonuz Carciu” në fshatin Tregan të Njësisë Administrative Tregan, Elbasan.
- Marrjen e masave nga MAS-ja për hartimin/miratimin e urdhërit në funksion të shpalljes së thirrjes për financimin e projekteve për infrastrukturën shkollore e sportive, për njësitë e vetëqeverisjes vendore lidhur me projektet me cikël financimi 2024-2025, në kuadër të përgatitjes të programit afatmesëm buxhetor dhe mbështetur në objektivat e përcaktuara në strategjinë e zhvillimit të arsimit parauniversitar.

²¹ Shkronja “e”, e pikës 3, të nenit 18, të ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

- Marrjen e masave për vlerësim për të parë gjendjen dhe nevojat për investime në mënyrë që të qendrëzohen ndërhyrjet dhe koordinimin e punës për të bërë të mundur garantimin e kësaj të drejte kushtetuese për fëmijët.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 8454/1999 organet, të cilave AP-ja u ka drejtuar rekomandime, duhet t'i shqyrtojnë ato dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit, ndërmjet institucioneve tona, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, lutemi shqyrtimin e këtij rekomandimi!

K O M I S I O N E R

Olta ALIAJ